



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KORÇË

Korçë, më 01/12/2017

TAKIM PËR BUXHETIMIN ME PJESËMARRJE ME KOMISIONIN KËSHILLIMOR  
QYTETAR VENDOR

Bazuar në Ligji 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, Ligji 119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe Ligji 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, në vijim të procesit të përgatitjes së projektbuxhetit për vitin 2018, zhvilluam një takim në datë 01/12/2017 me Komisionin Këshillimor Qytetar Vendor.

Në takim morën pjesë: Kryetari i Bashkisë Sotirajq Filo, staf i bashkisë, Komisioni Këshillimor Qytetar Vendor.

Gjatë takimit u diskutuan çështje të rëndësishme për komunitetin për të vendosur së bashku prioritetet e investimeve me qëllim përmirësimin e jetesës.

Pjesëmarrësit sollën në vëmendje dhe shqyrtuan disa kërkesa dhe problematika, të cilat janë të listuara si më poshtë:

- Problemi i ndotjes elektromagnetike.
- Ndotja e ajrit nga faktorë të ndryshëm, veçanërisht nga djegia e druve të zjarrit dhe pastrimi i qytetit.
- Informimi publik për aktivitetet artistike.
- Shtimi dhe respektimi i hapësirave të gjelbra.
- Mbështetje financiare për gazetatat lokale.
- Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e banjove publike.
- Niveli i taksave për shoqërinë civile.



